



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKT VENDIM

Nr. _____, datë _____

PËR

PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR KUJDESHIN ALTERNATIV
NË FAMILJE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, dhe 100, të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i ligjit

1. Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave dhe procedurave për kujdesin alternativ në familje për fëmijët pa kujdes prindëror ose në rrezik për të humbur këtë kujdes, si një nga format e përkuqjesit alternativ ndaj fëmijëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës në Republikën e Shqipërisë.

2. Ky ligj përcakton rregulla për:

- a) shërbimin e kujdesit alternativ në familje;
- b) subjektet e përfshira në sistemin e kujdesit alternativ në familje;
- c) kushtet, standardet, dhe procedurat e ofrimit të kujdesit alternativ në familje;
- ç) strukturat përgjegjëse publike dhe jo-publike për kujdesin alternativ në familje;
- d) të drejtat e fëmijëve që përfitojnë kujdes alternativ në familje,
- e) të drejtat dhe detyrimet e familjeve, dhe të strukturave përgjegjëse për organizimin, zbatimin, monitorimin dhe inspektimin e kujdesit alternativ në familje.

Neni 2

Qëllimi i ligjit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTILIGJ

Nr. _____, datë _____

PËR KUDDESIN ALTERNATIV NË FAMILJE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

- pavarësisht mbështetjes sociale, nuk janë në gjendje të ofrojnë kujdes të përshtatshëm;
- e) Fëmijë në nevojë për mbrojtje, përsishië ato që përballen me dhunë, abuzim, trafikim, neglizhim, shfrytëzim, apo në rrethana të verifikuara që përbejnë rrezik serioz për jetën, sigurinë apo zhvillimin e tyre;
 - f) Fëmijë shqiptar, pa shtetësi apo me shtetësi të huaj të identifikuar në territorin e Republikës së Shqipërisë, fëmijë të pashoqëruar, të ndarë nga të dy prindërit ose të atërmit e tjerë të familjes dhe për të cilin nuk kujdeset ndonjë person madhor;
 - g) Fëmijë me aftësi të kufizuara, për të cilët prindërit nuk janë në gjendje të ofrojnë kujdes, përkohësisht ose në mënyrë të përhershme, për shkak të kushteve të vështira social-ekonomike, problemeve të rënda të shëndetit mendor ose faktorëve të ngjashëm;
 - h) Fëmijë të ndarë nga familjet e tyre për shkak të konflikteve të armatosura, emergjencave humanitare, kërkesave për azil, emigrimit të detyruar ose fatkeqësi natyrore;
 - i) Fëmijë për të cilët është hequr e drejta prindërore me vendim gjykatë dhe nuk kanë asnjë person tjetër të ngarkuar me përgjegjësinë ligjore për t'u përkujdesur për ta;
 - j) Fëmijë të lindur nga nëna të mitura në pamundësi për të ushtruar përgjegjësinë prindërore, në rastet kur mungon rrjeti mbështetës në familje.
3. Kategoritë që nuk përfillojnë nga shërbimet e kujdesit alternativ në familje janë, por nuk kufizohen në, sa vijon:
- a) Fëmijë në konflikt me ligjin, për të cilët është dhënë një masë që kufizon lirinë personale, me vendim të formës së prerë;
 - b) Fëmijë në kujdesin e përkohshëm të një institucioni shëndetësor për qëllime mjekësore afatshkurtra dhe që prindërit kanë ruajtur përgjegjësinë prindërore.

Neni 4

Përkufizimet

1. Qëllimi i këtij ligji është të garantojë ofrimin e shërbimit të kujdesit alternativ në familje në një mjedis të përshatshëm familjar për fëmijët në nevojë për përkujdes dhe mbrojtje.
2. Ligji synon të ruajë dhe garantojë zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijës në një mjedis të sigurt, mbështetës dhe përfshirës familjar, në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës, duke marrë parasysh nevojat individuale dhe promovuar zhvillimin e shëndetshëm të tij/saj.

Neni 3

Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për çdo fëmijë pa kujdes prindëror ose në rrezik për të humbur këtë kujdes, në nevojë për përkujdes dhe mbrojtje.
2. Kategoritë e fëmijëve që përfitojnë nga shërbimi i kujdesit alternativ në familje përfshijnë, por nuk kufizohen në, sa vijon:
 - a) Fëmijë pa kujdes prindëror, kur asnjë nga prindërit nuk është i pranishëm ose nuk është në gjendje të ofrojë kujdes të përshatshëm, përfshirë rastet kur njëri prind është fizikisht i munguar dhe tjetri është në pamundësi për të ushtruar përgjegjësinë prindërore;
 - b) Fëmijë të braktisur;
 - c) Fëmijë me të dy prindërit e vendosur në institucionet e dënimit penal nën masën e heqjes së lirisë, të cilët nuk kanë kujdestar ligjor dhe mbeten pa kujdesin e përshatshëm familjar.

- familjar, që ofrohet në mënyrë vullnetare nga anëtarë të familjes së zgjeruar ose nga familje me lidhje të ngushta familjare e shoqërore me fëmijën, përfshirë anëtarë të familjes së zgjeruar së fëmijës, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- i) “Inspektimi” është proces i strukturuar dhe i vazhdueshëm, i kryer nga inspektoriati përçjegjës, me qëllim identifikimin e rasteve të shkeljeve të rregullave për kujdesin alternativ në familje, garantimin e cilësisë së shërbimit të kujdesit alternativ në familje dhe mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës së vendosur në kujdes alternativ në familje;
- j) “Mbështetje gjatë dhe pas kujdesit alternativ në familje” nënkupton ofrimin e një mbështetje të vazhdueshme përmes një pakeje të shërbimeve dhe ndërhyrjeve të ofruara fëmijës dhe familjes kujdestare gjatë dhe pas përfundimit të periudhës së kujdestarisë, për të lehtësuar tranzicionin në familjen e mëparshme të fëmijës, në familjen birësuese ose në një tjetër familje që ofron shërbimin e kujdesit alternativ në familje, për të ruajtur sigurinë emocionale dhe për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm dhe të pavarur të fëmijës;
- k) “Monitorimi” është procesi i ndjekjes dhe vlerësimit të përgjithshëm dhe periodik të zbatimit të rregullave në fuqi për kujdesin alternativ në familje, me qëllim garantimin e zbatimit të ligjit për kujdesin alternativ në familje, vënien në pah të mangësive dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të ofrimit të shërbimit të kujdesit alternativ, procesi i vëzhgimit në terren, mbledhjes së të dhënave dhe vlerësimit të kushteve të kujdesit alternativ në familje, si dhe të zbatimit të planit individual të kujdesit, për sigurimin e cilësisë së shërbimit dhe mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës së vendosur në kujdes alternativ në familje;
- l) “Ofrues i shërbimit” është familja e përzgjedhur sipas kritereve të këtij ligji, dhe që monitorohet për ofrimin e shërbimit të kujdesit alternativ;

I. Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Familje kujdestare” është familja që merr përgjegjësinë për të strehuar dhe për t’u përkujdesur për një ose më shumë fëmijë pa kujdes prindëror, me qëllim ofrimin e një mjedisi familjar, kushte për mirërrijë, pëmbushje të nevojave dhe mbështetje emocionale, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- b) “Fëmijë” është çdo person nën moshën 18 vjeç. Në rastin kur moshë është e pamundur të përcaktohet saktë por ka arsye të besohet se personi është fëmijë, ai/ajo konsiderohet fëmijë, në kuptim të këtij ligji, derisa moshë e tij të përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi;
- c) “Fëmijë i pashoqëruar” ka të njëjtin kuptim si në legjislacionin në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës në Republikën e Shqipërisë;
- d) “Fëmijë në nevojë për mbrojtje” ka të njëjtin kuptim si në legjislacionin në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës në Republikën e Shqipërisë;
- e) “Fëmijë pa kujdes prindëror” është fëmija që, për shkak të rrethanave të ndryshme, nuk ndodhet nën kujdesin efektive të asnjërit prej prindërve dhe ka nevojë për mbrojtje dhe kujdes alternativ në familje;
- f) “Kujdesi alternativ në familje” është një formë e shërbimit të përkujdesit alternativ në familje që i ofrohet një fëmijë në përputhje me rregullat e këtij ligji, të cilit/cilës i është njohur e drejta për kujdes alternativ në familje, dhe që është i/e regjistruar në Regjistrin e kujdesit alternativ në familje në Shqipëri;
- g) “Kujdesi alternativ profesional” është formë e specializuar e shërbimit të kujdesit alternativ në familje, e ofruar nga familje të trajnuara dhe të licencuara, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

alternativ në familje;

- c) Nevoja dhe përshatshmëria, sipas të cilës fëmija vendoset në kujdes alternativ në familje vetëm kur është e domosdoshme dhe në atë formë që i përgjigjet më mirë nevojave të tij/saj individuale. Çdo vendim merret mbi bazën e një vlerësimi gjithëpërfshirës të historikut të fëmijës, gjendjes shëndetësore, edukative dhe emocionale, si dhe kapaciteteve të familjes biologjike dhe asaj pritëse për të ofruar kujdes të përshatshëm;
- d) Pjesëmarrja aktive, sipas të cilës fëmija ka të drejtë të informohet, të dëgjohet dhe të shprehë mendimin e tij/saj për çdo vendim që prek jetën dhe zhvillimin e tij/saj. Ky parim zbatohet përmes sigurimit të informacionit të qartë dhe të kuptueshëm për moshën dhe zhvillimin e fëmijës, përfshirjes së tij/saj në proceset e vlerësimit, dhe dokumentimit të mendimit të tij/saj në prani të profesionistëve të trajnuar për komunikimin me fëmijët;
- e) Barazia dhe mosdiskriminimi, sipas të cilit çdo fëmijë në kujdes alternativ gëzon të drejtën e një trajtimi të drejtë dhe të barabartë me fëmijët e tjerë, pa dallim gjinie, etnie, origjine, statusi shoqëror, gjendje shëndetësore, aftësie të kufizuar apo çdo karakteristikë tjetër personale. Familja që ofron kujdes alternativ është e detyruar të sigurojë trajtim të barabartë dhe respektim të plotë për të drejtat e fëmijës;
- f) Qëndrueshmëria e marrëdhënieve shoqërore dhe familjare sipas të cilës vendimet për vendosjen e fëmijës marrin në konsideratë aftësinë gjeografike dhe sociale për të ruajtur lidhjet ekzistuese me familjen, komunitetin dhe shoqërinë. Fëmijët vëllezër e motra nuk ndahen, përveçse kur kjo është në kundërshtim të qartë me interesin më të lartë të tyre. Në raste ndarjeje, merren masa që fëmijët të ruajnë kontaktet dhe marrëdhëniet mes tyre;

- m) “Plani individual i kujdesit” është dokumenti i personalizuar që përshkruan dhe adreson nevojat specifike të fëmijës së vendosur në kujdes alternativ në familje dhe veprimet konkrete që ndërmerren për të garantuar mirëqenien, zhvillimin dhe mbrojtjen e fëmijës në mjedisin e kujdesit alternativ në familje;
- n) “Riintegrim në familje” është procesi i kthimit të fëmijës nga kujdesi alternativ në familjen biologjike/të mëparshme ose në familje birësuese, i cili realizohet në mënyrë të planifikuar dhe të mbështetur përmes ndërhyrjeve profesionale, për të garantuar qendrueshmërinë dhe mirëqenien afatgjatë të fëmijës në familje.

Neni 5

Parimet e ofrimit të kujdesit alternativ në familje

Kujdesi alternativ në familje udhëhiqet nga parimet themelore, si vijon:

- a) Interesi më i lartë i fëmijës, që nënkupton se çdo vendim merret në funksion të sigurimit të zhvillimit fizik, emocional, mendor, moral dhe shoqëror të fëmijës. Ky parim përshin të drejtën e fëmijës për t'u rritur në një mjedis familjar të sigurt, të qendrueshëm dhe mbështetës, që garanton vazhdimësinë e kujdesit dhe të lidhjeve të tij/saj personale;
- b) Parandalimi i ndarjes nga familja biologjike që nënkupton se vendosja në kujdes alternativ është masa e fundit e cila ndërmerret vetëm pas shterimit të të gjitha formave të ndërhyrjes mbështetëse dhe parandalimit për forcimin e kapaciteteve prindërore dhe familjare. Sipas këtij parimi, strukturat përgjegjëse janë të detyruara të ofrojnë programe këshillimi, shërbime mbështetëse në banesë dhe dërfshirjen e rrethit të

- legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Familja kujdestare dhe organet kompetente marrin të gjitha masat për ruajtjen dhe mospublikimin e të dhënave të fëmijëve, me përjashtim të rasteve të përcaktuara me ligj ose kur kërkohet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.
 3. Shkelja e dispozitave që mbrojnë të dhënat personale të fëmijës përbën shkelje të rëndë ligjore dhe i nënshtrohet masave administrative dhe/ose penale në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi.

PJESA II

LLOJET, KRITERET DHE PROCEDURA E SHËRBIMIT TË KUJDESIT ALTERNATIV NË FAMILJE

Neni 8

Llojet e kujdesit alternativ në familje

1. Kujdesi alternativ në familje ofrohet si kujdes alternativ profesional ose kujdes alternativ vullnetar.
2. Lloji i kujdesit alternativ në familje përcaktohet në përputhje me vlerësimin individual të nevojave të fëmijës dhe interesin më të lartë të tij/saj.
3. Kur fëmija është në rrezik të menjëhershëm dhe nuk mund të qëndrojë në mjedisin aktual familjar, njësia/punonjësi për mbrojtjen e fëmijës dhe njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit në nivel vendor marrin masa urgjente për vendosjen në kujdes alternativ, sipas këtij ligji.

g) Ruajtja e identitetit, sipas të cilit ofrimi i kujdesit alternativ në familje respekton edhe identitetin kulturor, etnik, fetar dhe gjuhësor të fëmijës.

Neni 6

Bashkëpunimi ndërinstitutional

1. Strukturat përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës, strukturat përgjegjëse të shërbimeve sociale, institucionet arsimore, shëndetësore, organet e rendit dhe të drejtësisë, dhe organizatat e shoqërisë civile bashkëpunojnë ngushtë me qëllim hartimin dhe zbatimin e planit individual të kujdesit dhe mbështetjen e fëmijës gjatë dhe pas kujdesit alternativ në familje.
2. Bashkëpunimi ndërinstitutional mes strukturave përgjegjëse për kujdesin alternativ në familje bazohet në parimin e interesit më të lartë të fëmijës, ruajtjen dhe respektimin e dinjitetit të fëmijës, privatesisë së tij/saj dhe respekton çdo parim sipas këtij ligji.

Neni 7

Mbrojtja e të dhënave personale

1. Të dhënat personale të fëmijës në nevojë për vendosje apo të vendosur në kujdes alternativ në familje, si dhe të familjes që ofron shërbimin e kujdestarisë familiare përpunohen nëa

- a) familje të të atërmeve të fëmijës, si gjyshi, gjyshja, motra ose vëllai i rritur, ungji, emta, nipi apo mbesa;
 - b) përjashitësit, nga familje të atërm të tjerë të fëmijës;
 - c) familje që nuk kanë lidhje familjare me fëmijën.
2. Ofrimi i shërbimit të kujdesit alternativ vullnetar në familje i nënshtrohet detyrimit për monitorim dhe inspektim, sipas vlerësimit të strukturave përgjegjëse të këtij ligji.

Neni 11

Masa parandaluese dhe ndërgjegjëse

1. Bashkitë marrin masa të vazhdueshme me qëllim që nga familja, për forcimin e prindërimit në interesin më të lartë të fëmijës, trajtimin në kohë të situatave dhe shkaqeve që çojnë drejt cenimit të interesit më të lartë të fëmijës, parandalimin e ndarjes së fëmijës nga familja biologjike dhe ajo aktuale dhe vendosjes së fëmijëve në kujdes alternativ në familje, identifikimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje në juridiksionin e tyre.
2. Bashkitë marrin masa të vazhdueshme për ndërgjegjësimin e familjeve për angazhimin si familje kujdestare.

Neni 12

Kriteret dhe procedura e ofrimit të shërbimit të kujdesit alternativ në familje

1. Kujdesi alternativ në familje ofrohet nga subjekte që plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - a) janë në moshë madhore, dhe gëzojnë aftësi të plotë për të vepruar;
 - b) kanë shtetësi shqiptare ose leje të rregullt qëndrimi në Republikën e Shqipërisë.
 - c) kanë vendbanim të përhershëm dhe jetojnë në Republikën e Shqipërisë;

4. Kur kushtet e ofrimit të kujdesit alternativ nga familja kujdestare ndryshojnë, njësia/punonjësi për mbrojtjen e fëmijës dhe njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit në nivel vendor marrin menjëherë masat e përshtatshme për garantimin e vazhdimësisë së kujdesit alternativ në familje, përfshirë edhe ndryshimin e familjes kujdestare ose të llojit të kujdesit alternativ.
5. Rregullat për përcaktimin e llojit të kujdesit alternativ, si dhe kushtet dhe procedurat për fillimin, ushtrimin dhe përfundimin e kujdesit alternativ sipas llojit, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9

Kujdesi alternativ profesional në familje

1. Kujdesi alternativ profesional në familje ofrohet si kujdestari e specializuar dhe nga familje të licencuara.
2. Kujdesi alternativ profesional në familje ofrohet si kujdestari emergjence për raste të nevojës urgjente, ose si kujdestari e specializuar për kategori të caktuara fëmijësh vulnerabël.

Neni 10

Kujdesi alternativ vullnetar në familje

1. Kujdesi alternativ vullnetar në familje ofrohet bazuar në vlerësimin e strukturave

njohtur të dhe aftësitë e nevojshme sipas llojit të kujdesit alternativ. Modulet e trajnimit miratohen nga autoriteti përgjegjës për sigurimin e cilësisë së shërbimeve, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Me përfundimin e kujdesit alternativ në familje, njësia/punonjësi për mbrojtjen e fëmijës dhe njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit marrin masa të menjëhershme për vendosjen e fëmijës në mbrojtje dhe kujdes alternativ, sipas rastit.
7. Rregullat për kriteret dhe procedurën e ofrimit të shërbimit të kujdesit alternativ në familje, përfshirë shqyrtimin e kërkesës, regjistrimin, trajnimin dhe përfundimin e ofrimit të shërbimit të kujdesit alternativ, si dhe për funksionimin e komisionit shumëdisiplinar, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave

Neni 13

Licencimi i kujdesit alternativ profesional në familje

1. Familjet që pëmbushin kriteret dhe kushtet e përcaktuara në këtë ligj për ofrimin e kujdesit alternativ profesional në familje pajisen me licencën për ofrimin e këtij shërbimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi për lejet dhe licencat.
2. Rregullat për licencimin e familjeve që ofrojnë kujdes alternativ profesional në familje miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 14

Regjistri i kujdesit alternativ në familje

1. Regjistri elektronik për kujdesin alternativ në familje përfshin të dhëna për familjet kujdestare dhe fëmijët e vendosur në kujdes alternativ në nivel bashkie dhe vendi. Regjistri

- d) nuk janë në moshën e pensionit, sipas legjislacionit në fuqi në vend, me përjashtim të rasteve të kujdesit alternativ vullnetar në familje nga të afërmit;
 - e) kanë kushte të përshatshme banimi, sigurojnë mjete të mjaftueshme të jetesës;
 - f) nuk janë të dënuar për një vepër penale;
 - g) nuk rezultojnë të jenë të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të të Dënuarve për Krime Seksuale sipas ligjit për Regjistrin Kombëtar të të Dënuarve për Krime Seksuale në fuqi;
 - h) ofrojnë mjedis të përshatshëm e të qëndrueshëm familjar;
 - i) janë në gjendje shëndetësore fizike ose mendore që nuk rrezikon shëndetin, mirëqenien ose zhvillimin e fëmijës;
 - j) nuk janë përjashtuar më parë nga ofrimi i kujdesit alternativ në familje;
 - k) kanë pëlqimin me shkrim të të gjithë anëtarëve të rritur të familjes së përbashkët për të kryer kujdestarinë;
 - l) kanë përfunduar trajnimin e detyrueshëm të miratuar nga autoriteti përgjegjës për sigurimin e cilësisë së shërbimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji.
2. Kriteret e pikës 1 të këtij neni zbatohen për të gjithë anëtarët e familjes kujdestare.
 3. Familjet e interesuara për të ofruar kujdes alternativ paraqesin kërkesë me shkrim pranë strukturave përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki ose përmes portalit elektronik unik *e-Albania*.
 4. Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në bashkëpunim me njësinë/punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve dhe njësinë e vlerësimit të nevojave dhe referimit në nivel vendor kryejnë vlerësimin paraprak dhe të thelluar të familjeve të interesuara. Vendimi për përzgjedhjen e familjeve jepet nga komisioni shumëdisiplinar në bashki dhe regjistrohet në Regjistrin e kujdesit alternativ.

e vlerësimit të nevojave dhe referimit në nivel vendor.

2. Njësia/punonjësi për mbrojtjen e fëmijës dhe njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit vlerësojnë nevojën e fëmijës për kujdes alternativ, ndërmarrin masat dhe kryejnë veprimet për vendosjen e fëmijës në kujdes alternativ në familje.
3. Procedurat e referimit dhe menaxhimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për kujdes alternativ në familje miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 16

Informimi dhe marrja e mendimit të fëmijës

1. Njësia/punonjësi për mbrojtjen e fëmijës informon familjen biologjike/aktuale të fëmijës si dhe fëmijën për mundësinë e vendosjes në një familje që ofron kujdes alternativ.
2. Fëmijës i merret mendim, në kushte miqësore dhe të përshatshme për moshën dhe kapacitetin zhvillimor, për preferencat për vendosjen në kujdes alternativ në familje. Mendimi i fëmijët merret në prani të një psikologu, verbalisht për fëmijët e moshës 6–10 vjeç dhe/ose me shkrim për fëmijët e moshës mbi 10 vjeç, dhe dokumentohet në çdo rast.

Neni 17

Vendimi për vendosjen e fëmijës në kujdes alternativ në familje

1. Njësia/punonjësi për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor krijon dosjen e menaxhimit të rastit në nevojë për kujdes alternativ, të cilën e përcjell pranë komisionit shumëdisiplinar në bashki për vendimmarrje.
2. Komisioni shumëdisiplinar në bashki merr vendim të arsyetuar, bazuar në përshatjen sa më të mirë të nevojave të fëmijës me familjen kujdestare. Vendimi për vendosjen e fëmijës

përmban të dhëna edhe për llojin dhe kohëzgjatjen e kujdesit alternativ, raportet e monitorimit dhe vlerësimet dhe qdo vendim të marrë nga struktura përkatëse sipas këtij ligji. Regjistri elektronik për kujdesin alternativ në familje organizohet si pjesë e sistemit elektronik të shërbimeve sociale dhe në përputhje me standardet teknike të sigurisë dhe privatesisë, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Bashkia përditëson regjistrin me të dhëna për familjet e licencuara për kujdesin alternativ në familje, familjet që ofrojnë shërbimin e kujdesit alternativ, si dhe fëmijët e vendosur në kujdestari alternative në familje në juridiksionin e saj. Shërbimi Social Shtetëror administron dhe konsolidon të dhënat elektronike për kujdesin alternativ në familje në nivel kombëtar.
3. Të dhënat e regjistrit elektronik për kujdesin alternativ në familje janë konfidenciale dhe trajtohen në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.
4. Rregullat për organizimin, funksionimin dhe qasjen në regjistrin e kujdesit alternativ në familje miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

PJESA III

PROCEDURA E OFRIMIT TË KUJDESH ALTERNATIV NË FAMILJE

Neni 15

Identifikimi, referimi dhe menaxhimi i rasteve në nevojë për kujdes alternativ në familje

1. Identifikimi dhe referimi dhe dhe menaxhimi i rasteve në nevojë për kujdes alternativ në

- paraqet kërkesën në gjykatë për vendosjen e fëmijës në familjen e përcaktuar, në përputhje me parashikimet e Kodit të Familjes.
2. Në rastet kur fëmija është në masë emergjente mbrojtje, vendoset menjëherë në familje që ofron shërbimin e kujdesit alternativ profesional emergjent, deri në marrjen e vendimit nga gjykata.
3. Dosja e përgatitur për rastin dhe vendimet administrative për përzgjedhjen e familjes që ofron kujdes alternativ, i bashkëfildhen kërkesës. Gjykata regjistron dhe shqyrton me përparësi kërkesat për vendosjen e fëmijës në familje kujdestare. Gjykata vendos për vendosjen e fëmijës në një familje kujdestare brenda jo më shumë se 10 ditëve pas regjistrimit të kërkesës, në përputhje me dispozitat e Kodit të Familjes.
4. Vendimi i gjykatës i njoftohet menjëherë njësisë/punonjësit për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor që ka ndjekur procedurën në gjykatë.

Neni 20

Procedura pas marrjes së vendimit në gjykatë

1. Njësia/punonjësi për mbrojtjen e fëmijës regjistron menjëherë vendimin e gjykatës për vendosjen e fëmijës në kujdes alternativ në familje në Regjistrin e kujdesit alternativ në familje dhe njofton të gjitha strukturat e shërbimeve sociale në bashki për vendimin e marrë.
2. Njësia/punonjësi për mbrojtjen e fëmijës merr masa për regjistrimin e fëmijës në gjendjen civile të familjes që ofron kujdes alternativ dhe për përgatitjen paraprake të fëmijës dhe familjes kujdestare me qëllim lehtësimin e akomodimit të fëmijës sipas vendimit të gjykatës.

1. në kujdes alternativ në familje përmban llojin dhe kohëzgjatjen e kujdesit alternativ, përgjegjësitë e organeve kompetente, masat paraprake për njohjen graduale të fëmijës me familjen kujdestare, masat mbështetëse për fëmijën, familjen kujdestare dhe, sipas rastit, familjen biologjike të fëmijës.
3. Rregullat për vlerësimin, procedurën dhe vendimin për vendosjen në kujdes alternativ në familje miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 18

Numri maksimal i fëmijëve në kujdes alternativ në familje dhe përjashtimet

1. Një familje ofron shërbimin e kujdesit alternativ në familje deri në tre fëmijë njëkohësisht, përfshirë edhe fëmijët biologjikë, të birësuar ose në kujdestari të saj. Përjashtimisht, më shumë se tre fëmijë vendosen në të njëjtën familje kujdestare në rastet kur kjo është në interesin më të lartë të fëmijëve dhe nuk cënon cilësinë e kujdesit, në bazë të vlerësimit të kryer nga njësia/punonjësi për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor.
2. Përparësi për vendosjen në të njëjtën familje që ofron shërbimin e kujdesit alternativ i jepet fëmijëve që janë motra dhe vëllezër me njëri-tjetrin.

Neni 19

Shqyrtimi në gjykatë i kërkesës për vendosjen e fëmijës në kujdes alternativ në familje

1. Njësia/punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, menjëherë me marrjen e vendimit të arsyetuar

- familjen e mëparshme nëse është e mundur, hartojnë një plan individual të kujdesit alternativ në familje për fëmijën e vendosur në kujdes alternativ në familje. Plan individual i kujdesit rishikohet rregullisht në bazë të vlerësimit të nevojave të fëmijës.
2. Familja kujdestare ofron shërbimin e kujdesit alternativ në familje në përputhje me standardet e ofrimit të këtij shërbimi. Familja kujdestare është e detyruar të njoftojë njësinë/punonjësën për mbrojtjen e fëmijës dhe njësinë e vlerësimit të nevojave dhe referimit për çdo ndryshim në rrethanat e ofrimit të shërbimit të kujdesit alternativ në familje.
 3. Standardet e ofrimit të shërbimit të kujdesit alternativ në familje miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

Neni 23

Vlerësimi periodik i situatës së fëmijës

1. Çdo rast kujdesi alternativ në familje vlerësohet periodikisht. Vlerësimi përfshin:
 - a) gjendjen fizike, mendore dhe emocionale të fëmijës së vendosur në kujdes alternativ në familje;
 - b) zhvillimin social dhe të edukimit të fëmijës;
 - c) cilësinë e marrëdhënies së fëmijës me familjen kujdestare dhe familjen biologjike/të mëparshme, sipas rastit;
 - d) rekomandime për vijimësinë ose ndryshim e vendosjes së fëmijës në kujdes alternativ në familje.
2. Vlerësimi kryhet nga njësia/punonjësi i mbrojtjes së fëmijës dhe njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit në nivel vendor, në bashkëpunim me një ekip shumëdisiplinar dhe, kur është e mundur, me organizatat e shoqërisë civile kontribuese në shërbimin e kujdesit alternativ sipas këtij ligji.

Neni 21

Përgatitja e fëmijës për vendosje në kujdes alternativ në familje

1. Masat paraprake për vendosjen e fëmijës në familjen e caktuar për kujdes alternativ përfshijnë:
 - a) hartimin e planit individual të kujdesit për vendosjen në familjen që ofron kujdes alternativ;
 - b) informimin dhe përgatitjen psiko-sociale të fëmijës në përputhje me kapacitetin zhvillimor dhe moshën;
 - c) përshtatjen graduale të fëmijës për vendosje në familjen kujdestare me familjen kujdestare.
2. Përgatitja e fëmijës për vendosje në familjen që ofron shërbimin e kujdesit alternativ sipas këtij neni është e detyrueshme në të gjitha rastet dhe përfshin një sërë masash në planin individual të kujdesit për fëmijën, si dhe familjen kujdestare, në përputhje me ritmin individual të përshtatjes së çdo fëmije, si dhe masa për mbështetjen dhe fuqizimin e familjes së mëparshme kur rikthimi i fëmijës është i mundur.
3. Rregullat për përgatitjen e fëmijës për vendosje në kujdes alternativ në familje miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 22

Standardet e ofrimit të shërbimit të kujdes alternativ në familje

1. Njësia/punonjësi për mbrojtjen e fëmijës dhe njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit

nevojave dhe referimit në bashki.

3. Njësia/punonjësi për mbrojtjen e fëmijës dhe njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit, ose sipas rasti, strukturat e shërbimeve sociale në bashki, shqyrtojnë dhe marrin vendim të menjëhershëm për rasin. Vendimet përshijnë masat e nevojshme, si ndërprerjen e menjëhershme të vendosjes së fëmijës në kujdes alternativ, referimin për heqjen e licencës së familjes kujdestare dhe/ose, kur është e nevojshme, njoftimin e organeve ligjzbatuese.
4. Bashkia publikon në faqen e saj zyrtare të internetit kontaktin për referimet e dyshuara për abuzim, neglizhencë apo shkelje të të drejtave të fëmijës gjatë kujdesit alternativ dhe merr masa për njohjen dhe shpërndarjen e këtij kontakti në institucione dhe struktura të tjera që ofrojnë shërbime për fëmijët.
5. Çdo rast i konfirmuar abuzimi, neglizhence apo shkeljeje të rëndë regjistrohet në Regjistrin e kujdesit alternativ në familje.

Neni 25

Monitorimi i ofrimit të shërbimit të kujdesit alternativ në familje

1. Njësia/punonjësit e mbrojtjes së fëmijës dhe njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit në nivel vendor monitorojnë kushtet e ofrimit të kujdesit alternativ në familje. Plani i monitorimit hartohet në përputhje me standardet e ofrimit të shërbimit të kujdesit alternativ në familje. Monitorimi realizohet çdo dy javë gjatë tre muajve të parë të vendosjes së fëmijës në kujdes alternativ, dhe më pas, çdo muaj, përmes një qasje gjithëpërfshirëse, që përfshin vëzhgim në terren të mjedisit të jetesës së fëmijës, vlerësim psikologjik, vlerësim të situatës arsimore, sociale dhe shëndetësore të fëmijës dhe intervista me fëmijën dhe familjen kujdestare, si dhe konsultime me shkollën, institucionet shëndetësore dhe aktorë të tjerë të përfshirë.

3. Raporti i vlerësimit periodik i njoftohet familjes kujdestare, fëmijës ose përfaqësuesit ligjor të fëmijës të vendosur në kujdes alternativ, familjes biologjike/të mëparshme, komisionit multidisiplinar në bashki, strukturave të shërbyemeve sociale në bashki, dhe drejtorive rajonale të Shërbimit Social Shetëror.
4. Kur raporti i vlerësimit rekomandon ndryshim të situatës së kujdesit alternativ në familje, njësia/punonjësi i mbrojtjes së fëmijës dhe njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit marrin masat për ndryshimet përkatëse sipas këtij ligji.
5. Rregullat, procedurat dhe instrumentet për vlerësimin periodik të situatës së fëmijës vendosur në shërbimin e kujdesit alternativ në familje miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 24

Raportimi për keqtrajtimin e fëmijëve të vendosur në kujdes alternativ në familje

1. Çdo rast i dyshuar për abuzim, neglizhencë apo shkelje të të drejtave të fëmijës gjatë ofrimit të shërbimit të kujdesit alternativ raportohet pranë:
 - a) njësisë/punonjësit të mbrojtjes së fëmijës ose njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit në nivel vendor;
 - b) strukturave të policisë ku ka vendbanimin familja kujdestare;
 - c) linjës së këshillimit për fëmijë dhe të rinj.
2. Raportimi kryhet nga çdo individ apo institucion, publik ose jo publik, që ka dyshime të arsyeshme për abuzim, neglizhencë apo shkelje të të drejtave të fëmijës së vendosur në kujdes alternativ në familje. Raportimi bëhet edhe në mënyrë anonime. Strukturat e shërbyemeve sociale, ato të policisë ose linja e këshillimit për fëmijë dhe të rinj informojnë

1. Inspektorati përgjegjës për shërbimet sociale inspekton në përputhje me kuadrin ligjor për inspektimin dhe këtë ligj rastet e ofrimit të shërbimit të kujdesit alternativ në familje. Inspektorati përgjegjës për shërbimet sociale bashkëpunon me strukturat monitoruese të ofrimit të kujdesit alternativ në familje sipas këtij ligji, me qëllim harmonizimin e planeve inspektimit dhe monitorimit dhe garantimin e realizimit të tyre në përputhje me standardet ligjore dhe profesionale.
2. Nëse gjatë inspektimit merret dijeni ose vlerësohet se një fëmijë i vendosur në kujdes alternativ në familje ndodhet në situatë emergjente abuzimi, neglizhimi apo mungese kujdesi nga familja kujdestare, inspektorati referon menjëherë rastin pranë njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit dhe njësisë/punonjësit për mbrojtjen e fëmijës, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë.
3. Për çdo vizitë monitorimi mbahet procesverbal i cili së bashku me vendimin e inspektimit regjistrohen në Regjistrin e kujdesit alternativ.
4. Rregullat dhe procedurat për organizimin dhe zbatimin e monitorimit dhe inspektimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 27

Pjesëmarrja e organizatave të shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë

1. Organizatat e shoqërisë civile me përvojë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe ofrimit të shërbimeve sociale, të licencuara sipas legjislacionit në fuqi, ofrojnë:
 - a) mbështetje, në bashkëpunim me bashkitë, për fëmijën dhe familjet që ofrojnë kujdes alternativ gjatë dhe pas kujdesit alternativ në familje;

2. Shërbimi Social Shtetëror, në nivel qendror dhe rajonal, monitoron zbatimin e standardeve të shërbimit të kujdesit alternativ në familje në të gjithë territorin e vendit. Monitorimi realizohet nëpërmjet shqyrtimit të dokumentacionit, dhe çdo katër muaj nëpërmjet vizitave në familje kujdestare me përzgjedhje rastësore.
3. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe Shërbimi Social Shtetëror sigurojnë zbatimin e rregullave të këtij ligji me qëllim harmonizimin e praktikave, mbledhjen dhe raportimin e të dhënave, dhe ofrojnë mbështetje teknike për strukturat përgjegjëse respektive lidhur me kujdesin alternativ.
4. Nëse gjatë monitorimit merret dijeni ose vlerësohet se fëmija i vendosur në kujdes alternativ në familje ndodhet në situatë emergjente abuzimi, neglizhimi apo mungese kujdesi nga familja kujdestare, rasti i referohet menjëherë rastin pranë njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit dhe njësisë/punonjësit për mbrojtjen e fëmijës Shërbimi Social Shtetëror, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë.
5. Për çdo vizitë monitorimi mbahet procesverbal i cili regjistrohet në Regjistrin e kujdesit alternativ.
6. Strukturat monitoruese të ofritit të kujdesit alternativ në familje sipas këtij neni bashkëpunojnë me qëllim harmonizimin e planeve të monitorimit dhe garantimin e realizimit të tyre në përputhje me standardet ligjore dhe profesionale.
7. Rregullat dhe procedura e monitorimit të situatës së fëmijës të vendosur në kujdes alternativ në familje miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

- ç) privatësi dhe dinjitet;
 - d) të ruajtur lidhjet me familjen aktuale, përveç rasteve kur kjo cenon interesin e tij më të mirë.
2. Fëmija ka të drejtë të informohet dhe të japë pëlqimin në përputhje me moshën, për të gjitha proceset që lidhen me vendosjen, vlerësimin, monitorimin dhe përfundimin e kujdesit alternativ në familje. Njësia/punonjësi i mbrojtjes së fëmijës dhe njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit marrin masa që fëmijët e vendosur në kujdes alternativ të informohen për linjat kombëtare të telefonit për fëmijë dhe kontaktet në bashki, si dhe të drejtën e tyre për të kontaktuar lirishit me to.

Neni 29

Detyrimet e familjes kujdestare

1. Familja kujdestare ka për detyrë të:
- a) sigurojë mjedis të sigurt, të shëndetshëm dhe përfshirës për zhvillimin e fëmijës;
 - b) respektojë të drejtat e fëmijës dhe të promovojë pjesëmarrjen e tij në vendimmarrje;
 - c) ndjekë procesin e bashkëpunimit me strukturat shtetërore dhe raportoje rregullisht për ecurinë e fëmijës;
 - ç) garantojë ruajtjen e marrëdhënieve të fëmijës së vendosur në kujdes alternativ me familjen biologjike/e mëparshme;
 - d) pranojë monitorimin, vlerësimin dhe inspektimin nga autoritetet përgjegjëse;
 - e) njoftojë menjëherë njësinë e vlerësimit të nevojave dhe referimit dhe njësinë/punonjësin e mbrojtjes së fëmijës për çdo situatë që cenon mirëqenien e fëmijës.

- b) trajnim, mbështetje dhe këshillim profesional, në bashkëpunim me bashkitë, për familjet kujdestare;
 - c) mbështetje për forcimin e kapaciteteve të bashkive për shërbimin e kujdesit alternativ në familje.
2. Bashkitë promovojnë bashkëpunimin me dhe kontributin e organizatave të shoqërisë civile si pjesë e sistemit kombëtar të kujdesit alternativ në familje.
 3. Rregullat për licencimin e organizatave të shoqërisë civile dhe bashkëpunimin me bashkitë për ofrimin e shërbimeve të kujdesit alternativ në familje miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

PJESA IV

TË DREJTAT DHE DETYRIMET

Neni 28

Të drejtat e fëmijës në kujdes alternativ në familje

1. Gjatë qëndrimit në kujdes alternativ në familje, fëmija gëzon të gjitha të drejtat që rrjedhin nga legjislacioni vendas dhe ndërkombëtar për të drejtat e fëmijës, përfshirë të drejtën për:
 - a) mbrojtje nga çdo formë dhune, abuzimi apo shfrytëzimi;
 - b) arsim, kujdes shëndetësor, përkujdes emocional dhe psikologjik, përfshirje sociale dhe zhvillim të gjithanshëm për të garantuar zhvillimin e plotë të potencialeve të fëmijës;
 - c) rresëtimarie në vendimmarrje në e rreth drejtmbërdrejt sinas moshës kapacitetit

PJESA V

FINANCIMI I SHËRBIMIT TË KUJDESIT ALTERNATIV NË FAMILJE

Neni 31

Parimet e financimit

1. Shërbimi i kujdesit alternativ në familje financohet nga buxheti i shtetit, buxhetet e njësisve të vetëqeverisjes vendore dhe burime të tjera të ligjshme.
2. Financimi i shërbimit të kujdesit alternativ bazohet në:
 - a) llojin e kujdesit alternativ në familje,
 - b) kohëzgjatjen e kujdesit alternativ në familje,
 - c) nevojat e veçanta të fëmijës,
 - ç) numrin e fëmijëve të vendosur në kujdes alternativ në të njëjtën familje.
3. Financimi përftshin financimin për shpenzimet për fëmijën e vendosur në kujdes alternativ në familje, si dhe për familjen kujdestare, sipas përcaktimeve në këtë ligj.

Neni 32

Mbështetja financiare për fëmijët e vendosur në kujdes alternativ në familje dhe familjen kujdestare

1. Familja që ofron shërbimin e kujdesit alternativ profesional përfiton një paketë mbështetje financiare për ofrimin e shërbimit të kujdesit alternativ profesional, e cila përftshin:
 - a) pagë mujore për ofrimin e shërbimit të kujdesit alternativ profesional në familje;

2. Familja kujdestare gëzon të drejtën, të shfaqë informata të familjes së vendosur në kujdes alternativ, jashtë vendit, me kushtin që të informojë nënshkrimin/punonjësin e mbrojtjes së familjes në bashki/një dhe institucionet e rendit në bashkinë përkatëse.
3. Familja kujdestare ka detyrimin të informojë menjëherë nënshkrimin e vlerësimit të nevojave dhe referimit dhe nënshkrimin/punonjësin e mbrojtjes së familjes për çdo ndryshim të rëndësishëm në gjendjen e familjes kujdestare.

Neni 30

Të drejtat e familjes biologjike / të mëparshme

1. Familja biologjike/ e mëparshme e fëmijës, përveç rasteve të përjashtuara me vendim gjyqësor, ka të drejtë të:
 - a) informohet për vendosjen e fëmijës në kujdes alternativ në familje si dhe të informohet periodikisht për gjendjen e fëmijës së vendosur në kujdes alternativ në familje;
 - b) ruajtë kontakte me fëmijën në mënyrë të sigurt dhe të mbështetur nga njësi/punonjësi për mbrojtjen e fëmijës në bashki;
 - c) përfaqësohet në programet e prindërimit dhe ato për riintegrimin e fëmijës në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës;
 - d) angazhohet aktivisht në tejkalimin e situatës, përmes një pakete të plotë mbështetëse për fëmijën e vendosur në kujdes alternativ.
2. Marrëdhëniet ndërmjet familjes biologjike/të mëparshme dhe familjes që ofron shërbimin e kujdesit alternativ rregullohen nga njësi/punonjësi i mbrojtjes së fëmijës dhe njësi e vlerësimit të nevojave dhe referimit në nivel vendor dhe ianë pjesë e planit individual të

- b) Hegje e përkohshme ose përfundimtare e statusit si familje kujdestare.
2. Masat sipas pikës 1 të këtij neni jepen në përputhje me parimin e përpjesëtueshmërisë. Në rast se shkelja përsëritet ose në raste flagrante të keqtrajtimit të fëmijës, familja humbet përgjithmonë të drejtën për të ofruar kujdes alternativ në familje. Nëse shkeljet e identifikuar përbëjnë veprë penale, njësia/punonjësi i mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor paraget kallëzim penal, në përputhje me Kodin Penal.
3. Vendimi për heqjen e kujdestarisë jepet nga komisioni shumëdisiplinar për kujdesin alternativ në familjen në bashki me propozimin e njësisë/punonjësit të mbrojtjes së fëmijës. Ky vendim është i ankimmueshëm në përputhje me legjislacionin në fuqi. Deri në marrjen e vendimit formë të prerë, familja kujdestare pezullohet nga e drejta e ofrimit të shërbimit të kujdesit alternativ në familje. Në raste të tilla, në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës, fëmija i vendosur në kujdes alternativ në familje transferohet në një familje që ofron kujdes alternativ profesional emergjent, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe aktene nënligjore në zbatim të tij.

Neni 34

Masat për punonjësit përgjegjës për kujdesin alternativ në familje

1. Punonjësit e ngarkuar me detyra dhe përgjegjësi në bazë të këtij ligji që shkelin rregullat e këtij ligji, i nënshtrohen masave disiplinore sipas ligjit përkatës që rregullon marrëdhënien e tyre të punës. Organet eprorë të këtyre punonjësve, me nismën e tyre ose me kërkesë të cilindo në djeni të këtyre shkeljeve, janë të detyruar të fillojnë procedimin disiplinor. Mosfillimi i procedimit disiplinor përbën shkak për fillimin e procedimit disiplinor ndaj organit epror apo fillimin e ndjekjes penale sipas rasis, kur ka elementë të veprës penale.

- b) pagesë mujore dhe vjetore për çdo fëmijë të vendosur në kujdes alternativ në familje.
1. Familjet që ofrojnë shërbimin e kujdesit alternativ përfitojnë mbështetje financiare për të përballuar shpenzimet e kujdesit për fëmijën/t. Pagesa mujore për fëmijën/t e vendosur në kujdes alternativ në familje kryhet periodikisht, një herë në muaj, përmes transferimit bankar.
 2. Familjet që ofrojnë shërbimin e kujdesit alternativ profesional dhe që marrin pagesë për këtë shërbim, regjistrohen si të punësuar pranë sigurimeve shoqërore. Atyre u paguhen sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, dhe puna e kryer i njihet si vjetërsi pune për sigurimet shoqërore, për efekt përfitimi pensioni, barrëindjeje, aksidenti në punë, sëmundjeje profesionale dhe siguri shëndetësor.
 3. Masa e financimit për kujdesin alternativ në familje dhe rregullat e përfitimit të financimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

PJESA VI
MASAT DHE E DREJTA E ANKIMIT

Neni 33

Masat për familjet që ofrojnë kujdes alternativ në familje

1. Familjet që ofrojnë kujdes alternativ në familje që shkelin detyrimet e përcaktuara në këtë ligj, i nënshtrohen masave si vijon:
 - a) Paralajmërim zvarr nën hetim dhe ndalim dhe masat e tjera të caktuara në ligjin për

Shqyrtimi i ankesave

1. Pranë çdo bashkie ngrihet komisioni për shqyrtimin e ankesave lidhur me procesin e vendosjes në kujdes alternativ në familje dhe trajtimin në familjen që ofron kujdes alternativ në familje.
2. Ankesat regjistrohen në Regjistrin e kujdesit alternativ në familje dhe shqyrtohen brenda 15 ditëve nga data e regjistrimit. Në rast të mosdhënies së përgjigjes brenda këtij afati, ankuesi ka të drejtë të ndjekë rrugën gjyqësore të shqyrtimit të ankesës.
3. Komisioni për shqyrtimin e ankesave në bashki merr vendim të arsyetuar me shkrim, të qartë dhe të kuptueshëm duke marrë parasysh moshën dhe zhvillimin e fëmijës. Vendimi përmban edhe mjetet ligjore mbrojtëse, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative në fuqi. Vendimi i njoftohet menjëherë ankuesit.
4. Rregullat për organizimin dhe funksionimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave në bashki dhe për procedurën e shqyrtimit të ankesave, sipas këtij neni, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

PJESA VIII DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 37

Akte nënligjore

1. Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Këshilli i Ministrave miraton vendimet sipas nenit 8, pika 5, neni 12, pika 7, neni 13, pika 2, neni 14, pika 4, neni 15, pika 3,

2. Rastet e dyshuara të korrupsionit, shpërdorimit të detyrës ose mosveprimit nga ana e punonjësve e ngarkuar me detyra dhe përgjegjësi në bazë të këtij ligji dhe që sjellin pasoja për fëmijën, i referohen organeve kompetente për hetim penal.

PJESA VII

MJETET LIGJORE MBROJTËSE ADMINISTRATIVE

Neni 35

E drejta e ankimit

1. Çdo subjekt i përfshirë në procesin e kujdesit alternativ në familje ka të drejtë të paraqesë ankim administrativ kundër çdo vendimi për gjatë procesit të aplikimit dhe përzgjedhjes si familje që ofron kujdes alternativ në familje, ofrimit të shërbimit të kujdesit alternativ në familje apo përfundimit të këtij shërbimi, përfshirë edhe vendimet:
 - a) për refuzimin e përzgjedhjes si familje kujdestare;
 - b) për ndërprejen ose heqjen e të drejtës për ofrimin e kujdesit alternativ në familje;
 - c) që lidhen me përzgjedhjen e familjes që ofron kujdes alternativ në familje;
 - d) për masat ndaj familjes kujdestare.
2. Fëmija i vendosur në kujdes alternativ në familje ka të drejtë të paraqesë ankesa për procesin e vendosjes në kujdes alternativ në familje dhe trajtimin në familjen kujdestare. Ankesa paraqitet nga vetë fëmija ose përmes një përfaqësuesi ligjor, punonjësi social, psikologu, mësuesi të fëmijës ose nga një përfaqësues i organizatave të shoqërisë civile.

- nenit 18, pika 3, nenit 21, pika 3, nenit 23, pika 5, nenit 25, pika 7, nenit 26, pika 4, nenit 27, pika 3, nenit 32, pika 4, dhe nenit 36, pika 4 të këtij ligji.
2. Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ministri përgjegjës për çështjet sociale miraton udhëzimin sipas nenit 22, pika 4 të këtij ligji.

Neni 38
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

zhvillimin e një game te shërbimeve me vlerë komunitare, për të cilin mund nevojën për ndryshim rezidencial.

Projekti i kontributit në përbushjen e piketave të ndërmjetme në kuadër të procesit negociues të Kapitullit 23 – Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore, veçanërisht në fushën e garantimit të të drejtave të fëmijës, forcimit të mekanizmave administrative për mbrojtjen e tyre, si dhe harmonizimit të legjislacionit kombëtar me standardet e Bashkimit Evropian dhe instrumentet ndërkombëtare për kujdesin alternativ, në funksion të përparimit të procesit të integritetit evropian të vendit dhe forcimit të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri.

Në mbështetje të synimit të përgjithshëm, qëllimet kryesore të këtij ligji janë:

- organizimi dhe ofrimi i shërbimit të kujdesit alternativ në një mjedis të përshatshëm familjar për fëmijët në nevojë për përkujdes dhe mbrojtje, në rezik të mos pasjes së kujdesit prindëror, ose pa kujdes prindëror, me qëllim ruajtjen dhe garantimin e zhvillimit dhe mirëqenies së fëmijës.
- organizimi dhe ofrimi i shërbimit të kujdesit alternativ në familje, sipas nevojave individuale dhe në përputhje me parimin e interesit më të lartë të fëmijës, si dhe të promovojë zhvillimin e qëndrueshëm dhe të gjithanshëm të fëmijës në një mjedis të sigurt, mbështetës dhe përfshirës.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE